


SCC – 07– 0012

28 janar 2011

Paditësit



nga fshati Nakllë, Pejë
të përfaqësuar nga [REDACTED], Pejë)

Vs.

1. Kooperativa Bujqësore [REDACTED]
Drelje

të Paditurat

2. Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (e përfaqësuar nga UNMIK-u)
Kompleksi TSS, Zona Industriale, Prishtinë

Për: Palët dhe Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP)

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, Trupi Gjykues i përbërë prej Antoinette Lepeltier-Durel, , Kryesuese, Esma Erterzi dhe Sabri Halili, Gjyqtare, pas seancës vendim-marrëse të mbajtur me 28 janar 2011 lëshon këtë:

AKTGJYKIM

- 1. Padia e Paditësve pranohet si e bazuar dhe Paditësit njihen si pronarë të ngastrave kadastrale Nr. 26, 289 dhe 291 sipas fletës poseduese nr. 28, Zona Kadastrale Joshanicë, Rugovë, Pejë;**
- 2. Të paditurat obligohen që të lejojnë që këto ngastra të regjistrohen nga Drejtorati për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë (Komuna e Pejës) në emër të Paditësve brenda një muaji nga data e dorëzimit të këtij vendimi tek palët;**

3. NSH, Kooperativa Bujqësore [REDACTED] obligohet që t'ia paguan Padiësve shumën prej 50 (pesëdhjetë) Euro si kompensim të Taksës Gjyqësore dhe 50 (pesëdhjetë) Euro në Dhomën e Posaçme.

Rrethanat Faktike dhe Procedurale:

Me 11 dhe më pas me 17 janar 2007, Padiësit kanë deponuar padi duke kërkuar nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (Dhoma e Posaçme) caktimin e masës së përkohshme të parandalimit në mënyrë që të pezullohet privatizimi i ngastrave kadastrale nr. 26, 289 dhe 291 sipas fletës poseduese nr. 28, Zona Kadastrale Joshanicë, Rugovë, Pejë, si dhe ti konfirmoi ata si bashkë-pronarë të atyre ngastrave. Padiësit kanë pohuar se parcelat iu kishin marrë paraardhësve të tyre “gabimisht pa ndonjë bazë ligjore”.

Padiësit kanë deklaruar se paraardhësi i tyre, [REDACTED] i ka blerë nga [REDACTED] (emri tjetër [REDACTED]) disa ngastra të identifikuar si ngastra kadastrale nr. 25, 26, 289, 290 dhe 291, fleta poseduese nr. 30 (në at kohë) Zona Kadastrale Joshanicë, me sipërfaqe 13, 64, 22 ha. Ata kanë shpjeguar se ngastrat kadastrale nr. 25 dhe 290 me sipërfaqe 4, 96, 86 ha ishin regjistruar në emër të paraardhësit të tyre ndërsa ngastrat nr 26, 289 dhe 291 me sipërfaqe 8, 67, 33 ha më vonë ishin regjistruar në emër të Kooperativës Bujqësore [REDACTED], para-rendëse e Kooperativës Bujqësore [REDACTED]. Padiësit kanë pohuar se kalimi në emër të kooperativës bujqësore është bërë në vitin 1954 pa ndonjë bazë ligjore apo pa ndonjë vendim ligjor.

Padisë Padiësit ia kanë bashkangjitur edhe:

- Kontratën për shit-blerje Nr. 341 të datës 10 prill 1952, së bashku me shtatë dokumente lidhur me pagesën dhe vërtetimin e kontratës;
- dokumentet mbi vdekjen e [REDACTED] dhe [REDACTED], dy djemtë e të ndjerit [REDACTED];
- Shkresën-dokumentacionin e lëshuar nga Drejtorati për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë (Komuna e Pejës) me datë 12 dhjetor 2006, sipas të cilës nga viti 1932 e deri në vitin 1954 ngastrat nr 26, 289 dhe 291, fleta poseduese nr. 30, ZK Joshanicë me 8, 67, 33 ha ishin regjistruar në emër të [REDACTED] dhe që nga viti 1954 sipas regjistrit të ndërrimeve këto ngastra shihet se janë regjistruar në emër të Fermës Kolektive (trashëgimtare ligjore e të paditues së parë) me nr të fletës poseduese 33 (tani nr. 28), Z K Joshanicë;
- fletën poseduese nr, 28 në Zonën Kadastrale Joshanicë të datës 8 dhjetor 2006;
- Aktvendimin e Gjykatës Komunale të Pejës nr. 0.641/81, për të dëshmuar se ata kanë qenë posedues të ligjshëm të ngastrave kontestuese në vitin 1981, dhe Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë Ac. 369/81 me të cilin vërtetohej Aktgjykimi i Gjykatës Komunale të Pejës;
- Njoftimin për padi dhe kërkesën për masë të përkohshme parandaluese të dërguar në Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) me datë 10 janar 2007.

Padia dhe kërkesa i janë dërguar AKM-së me 29 janar 2007. Në letrën e parashtruar pranë Dhomës së Posaçme me 5 shkurt 2007, AKM ka cekur se edhe pse asetet e Kooperativës Bujqësore do të mund ti nënshtroheshin tenderit të datës 7 shkurt 2007, ngastrat nr. 26, 289 dhe 291 nuk do të shiteshin në ditën e tenderit. Andaj, AKM nuk ka parashtruar ndonjë parashtrësë.

Me 14 shkurt 2007, Dhoma e Posaçme e ka miratuar masën e përkohshme; me këtë Paditësit janë kushtëzuar që ta depozitojnë në Dhomën e Posaçme shumën prej 5000 Euro në mënyrë që ta kompensoi AKM-në për ndonjë dëm eventual.

Me 20 mars 2007, Paditësit kanë kërkuar nga Dhoma e Posaçme që të heqin dorë nga kërkesa për depozitim të 5,000 Euro si garancion për faktin se kjo do të rrezikonte ata që të ballafaqohen me shpenzimet familjare.

Parashtrësja e lart-cituar i është dërguar të Paditurave. Me 22 mars 2007, AKM ka kërkuar refuzimin e kërkesës së lart-cekur si të papranueshme.

Me 17 maj 2007, Dhoma e Posaçme e ka refuzuar kërkesën e Paditësve që të tërheqet kërkesa për depozitim të garancionit prej 5000 Euro si e papranueshme; kështu masa e përkohshme e parandalimit u bë e pavlefshme.

Me 28 maj 2007, Paditësit kanë dërguar autorizimin të nënshkruar nga të gjithë ata.

Pas një seance të pafrytshme për marrëveshje me negociatën, të datës 13 qershor 2007, AKM ka paraqitur mbrojtjen e saj me 27 qershor 2007. Ajo ka kërkuar refuzimin e padisë, duke pohuar se toka ishte regjistruar si pronë shoqërore e për pasojë ajo kishte të drejtë ta administroi atë, se toka i është ndarë NSH Rugovës nga Komuna e Pejës në vitin 1980 në shfrytëzim të përhershëm dhe se paditësit nuk kanë ngritur paraqitur ndonjë argument material për ta mbështetur padinë e tyre. AKM ka përkujtuar se ajo ka kompetencë mbi tokën e cila është regjistruar si pronë shoqërore në vitin 1989.

Me 25 korrik 2007, Paditësit e kanë paraqitur përgjigjen e tyre. Ata kanë argumentuar se vetëm shënimet kadastrale nuk japin titull pronësie dhe kanë ngritur argumentin se sipas Nenit 33 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Pronësore (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së nr. 6/80) titulli mbi pronësinë duhet të vërtetohet dhe pastaj të paditurat duhet të dëshmojnë se si i kanë fituar ngastrat e kontestuara. Paditësit kanë theksuar se në Kosovë nuk ka Libra mbi Tokën çka do të ishte bazë për dëshmi ekskluzive të pronësisë dhe se librat kadastral nuk mund të merren si të provë e besueshme për titull të pronësisë.

Lidhur me faktin se Komuna e Pejës ia ka ndarë të paditësve ngastrat e kontestuara për shfrytëzim të përhershëm, Paditësit kanë thënë se askush nuk ka të drejtë të transferoi më shumë të drejta se sa që ai i posedon personalisht.

AKM e ka paraqitur kundërpërgjigjen e saj me 14 gusht 2007. Ajo i ka përsëritur argumentet e mëhershme dhe edhe një herë ka cekur se Paditësit nuk e kanë vërtetuar titullin e tyre të pronësisë.

Me 17 shtator 2007, Dhoma e Posaçme ka mbajtur një seancë publike për administrim të provave. Në seancë Paditësit e kanë sqaruar zinxhirin dhe të drejtën e trashëgimisë si dhe kanë siguruar dokumentacion pranë Dhomës së Posaçme. Dhoma e Posaçme është përpjekur ta sqaroi bazën ligjore të pronësisë së NSH-së lidhur me kushtet e vëna në Nenin 3 të ligjit mbi Regjistrimin e Patundshmërisë (Gazeta Zyrtare e KSA Kosovës, nr. 37/71). AKM është përgjegjës se toka është regjistruar në fletën poseduese si pronë shoqërore dhe se ajo mund të prezantoi çfarëdo dokumenti lidhur me kalimin e titullit të pronësisë. Paditësit kanë rikujtuar se ata e kanë paditur në mënyrë të suksesshme të paditoren në vitin 1981 për posedimin e ngastrave kadastrale në fjalë, dhe se rezultati ka treguar se ata kanë qenë në posedim.

Përfaqësuesi i ftuar sipas rregullit i Zyrës Kadastrale në Pejë nuk ka qenë prezent në seancë. Palëve u është dhënë dy javë afat që të sigurojnë në Dhomën e Posaçme informacion shtesë rreth trashëgimisë dhe bazën ligjore të pronësisë dhe dy javë tjera për ti paraqitur parashtresat e tyre.

Me 27 shtator 2007, Paditësit ia kanë siguruar Dhomës së Posaçme një aktvendim mbi trashëgiminë dhe një certifikatë të datës 21 korrik 2007 nga Drejtorati për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë (Komuna e Pejës) i cili potenconte se ata nuk posedojnë ndonjë dokument i cili do të shërbente si bazë ligjore për ndërrimin e regjistrimit.

Me 28 shtator 2007, AKM i ka përsëritur parashtresat e saj të mëhershme dhe ka shpjeguar se sipas akteve të reformës agrare të viteve 50-ta personave privat nuk i është lejuar që të posedojnë më shumë se 10 hektarë tokë dhe kjo duhet të ketë qenë bazë ligjore e nacionalizimit, e më pas regjistrimit të pronësisë shoqërore. AKM ka debatuar se Paditësit është dashur që të hapin procedurë pranë Gjykatës Komunale në vitin 1987/88 në pajtim me Ligjin mbi Procedurën Administrative në mënyrë që ta rifitojnë titullin e tyre të pronësisë.

Në seancën publike të mbajtur me 23 janar 2008, palët kanë mbetur pranë argumenteve të tyre të mëhershme. AKM ka thënë se baza ligjore për pronësi shoqërore është Ligji Themelor mbi Shpronësimin kurse ka pranuar se nuk mund të prezantoi prova të shpronësimin apo nacionalizimit apo të procedurave tjera të transferim të së drejtës së pronësisë. Dhoma e Posaçme e ka shpallur procedurën si të mbyllur për shkak të paraqitjes së parashtresave të fundit dhe ka deklaruar se do ta jep gjykimin e saj.

Në parashtresat përfundimtare të datës 8 shkurt 2008, Paditësit e kanë komentuar ligjin në zbatim lidhur me padinë dhe kanë mbetur në tërësi pranë padisë së tyre.

Në parashtresat përfundimtare po ashtu të paraqitura me 8 shkurt 2008, AKM i ka përsëritur argumentet e saj të mëhershme.

Me 31 korrik 2008, procedura është pezulluar në bazë të një vendimi Ekzekutiv të UNMIK-ut të datës 29 korrik 2008. Pezullimi është hequr me 16 korrik 2009. Në të

njëjtën kohë Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) ishte thirrur në padi dhe iu kishte dërguar padia dhe parashtrirat e mëpasme.

AKP e ka paraqitur mbrojtjen e saj në Gjykatë me 30 tetor 2009. Ajo pajtohej me parashtrirat e mëhershme të AKM-së dh ka kërkuar refuzimin e padisë. AKP debaton se legjitimiteti pasiv i të paditues së parë duhet të shqyrtohet meqë nuk ka marrëdhënie midis Paditësve dhe të paditues së parë dhe se nuk ka dëme të shkaktuara nga ana e NSH-së për Paditësit. AKP ka pohuar se Paditësit nuk i kanë kërkuar të drejtat e pohuara të pronësisë që prej 60 viteve në mënyrë që tu shmangeshin pagimit të taksave. Ajo ka shtuar se regjistrimi i tokës në kontest në emër të NSH-së nuk mund të ishte gabim e po qe se kështu ka qenë rasti, atëherë Paditësit do ta kishin kërkuar korrigjimin. AKP po ashtu ka thënë se kalimi i pronësisë ka ndodhur meqë ngastrat në fjalë ishin braktisur. AKP ka parashtruar një kopje të vendimit të Kuvendit Komunal të Pejës Br. 02-463/264 të datës 30 qershor 1980 duke kërkuar që vendimi ka shërbyer si bazë ligjore për pronësi të NSH-së. Së fundi, AKP ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve procedurale.

Me 9 nëntor 2009, mbrojtja e AKP-së i është dërguar Paditësve të cilët nuk iu kanë përgjigjur.

Seanca ishte e caktuar për 16 mars 2010 ishte shtyrë për faktin se nuk ishte emëruar asnjë gjyqtar vendor në Dhomën e Posaçme.

Ndërkohë, me urdhrin e lëshuar me 1 mars 2009, nga Paditësit është kërkuar që të sqarojnë nëse dëshirojnë të përfaqësohen nga ndonjë avokat tjetër meqë avokati i tanishëm ka treguar se ai nuk do ti përfaqësoi më ata. Me parashtrirën e paraqitur me 12 prill 2010, i njëjti avokat ka shpjeguar se ai do ta vazhdoi përfaqësimin dhe se tërheqja ka qenë gabim , për shkak të keqkuptimit për lëndën për të cilën ftesa i referohej.

Me 10 maj 2010, lëshimi i vendimeve përfshirë edhe aktgjykimin mbi meritën në këtë procedurë i janë deleguar Nën-panelit.

Seanca pastaj ishte caktuar me 22 qershor 2010, por me kërkesë të përfaqësuesit të Paditësve ajo u shty për datën 21 shtator 2010.

Në këtë seancë të mbajtur me Trup Gjykses të plotë, përfshirë edhe gjykatësin vendor të emëruar në Dhomën e Posaçme, AKM dhe AKP i kanë mbrojt argumentet e tyre përkatëse. AKP ka cekur se për mënyrën se si ngastrat kontestuese janë bërë pronë shoqërore dhe për vendimin e lëshuar për këtë qëllim duhet pyetur Komunën e Pejës dhe se kjo komunë duhet të ketë qen e paditur në këto procedura.

Gjykata vendosi që të kërkoj nga Komuna e Pejës që t'ia siguroi Dhomës së Posaçme të gjitha dokumentet lidhur me të drejtat pronësore mbi ngastrat e kontestuar.

Komuna ne Pejës ë ka paraqitur përgjigjen e saj me 18 tetor 2010.

Seanca përfundimtare është mbajtur me 30 nëntor 2010. Paditësit dhe AKM i kanë dhënë deklaratimet e tyre përfundimtare gojore me komentime rreth parashtrësës së fundit të Komunës së Pejës.

Dhoma e Posaçme ka konstatuar se procedura gojore përfundoi.

Arsyetimi Ligjor:

1. Legjitimiteti pasiv i Kooperativës Bujqësore [REDAKTUAR]:

Legjitimiteti pasiv i NSH Kooperativa Bujqësore [REDAKTUAR] është kontestuar nga AKP e cila ka debatuar se nuk ka patur marrëdhënie midis Paditësve dhe kësaj NSH-je si dhe nuk i është shkaktuar dëm Paditësve nga ana NSH-së.

Dhoma e Posaçme nuk mund ta mbështes këtë argumentim. Ajo vë në pah se lënda e padisë është e drejta mbi pronësinë mbi ngastrat kadastrale nr. 26, 289 dhe 291 të regjistruara në fletën poseduese nr. 28, Zona Kadastrale Joshanicë, Rugovë, Pejë.

Lidhur me paditë pronësore si dhe të drejtat tjera pronësore, Paditësit duhej ta padisnin pronarin aktual siç paraqitet në dokumentacionin zyrtar lidhur me këto të drejta. Në rastin konkret, dokumentet kadastrale të siguruara nga Paditësit, pra, fleta poseduese nr. 28 e Zonës kadastrale Joshanicë dhe certifikata e shkruar me 12 dhjetor 2006 nga Drejtoriat për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë (Komuna e Pejës) tregojnë se ngastrat kontestuese janë regjistruar në emër të NSH Kooperativa Bujqësore në Joshanicë.

AKP nuk ka siguruar dokumentacion më të vonshëm që tregon se pronari aktual i këtyre ngastrave do të duhej të ishte Komuna e Pejës.

Si rrjedhojë, NSH ka legjitimitet pasiv në këtë procedurë.

2. e drejta pronësore mbi ngastrat e kontestuara:

Neni 20 i Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore përcakton:

“E drejta e pronësisë fitohet sipas vetë ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe me trashëgim. E drejta e pronësisë fitohet edhe në bazë të vendimit të organit shtetëror në kushtet dhe në mënyrën e caktuar me ligj.”

Kontrata e shit-blerjes është njëra ndër marrëdhëniet ligjore që do të lejonte fitimin e të drejtës pronësore.

Pos kësaj, Neni 3 i Ligjit mbi Regjistrimin e pasurive të patundshme në pronësi shoqërore përcakton:

“Regjistrimi i pasurisë së patundshme në pronësi shoqërore bëhet në bazë të:

- 1. vendimit të plotfuqishëm të gjykatës apo të ndonjë organi administrativ, i cili përcakton se pasuria e patundshme ka kaluar në pronësi shoqërore;*
- 2. kontratës së vërtetuar e cila përmban dispozita që saktësojnë se patundshmëria mund të regjistrohet si pasuri e patundshme ën pronësi shoqërore;*
- 3. deklaratës së vërtetuar unilaterale, me të cilën konfirmohet se pronari i patundshmërisë heq dorë nga të drejtat e tij/saj pronësore për pasurinë patundshme në dobi të bashkësisë shoqërore.”*

Në rastin konkret, Padiësit ia kanë siguruar Dhomës së Posaçme kontratën origjinale me shkrim mbi shitblerje nr. 341 të datës 10 prill 1952 sipas së cilës [REDAKTUAR] ia ka shitur [REDAKTUAR] ngastrat e kontestuara. Kjo kontratë mbanë referimin se është vërtetuar nga Kuvendi Komunal i Pejës.

Padiësit, po ashtu, ia kanë siguruar Dhomës së Posaçme edhe vërtetimin mbi trashëgiminë e cila sjell dëshmi se ata janë trashëgimtarët ligjor të të ndjerit [REDAKTUAR]

Vlefshmëria e kontratës së lart-cituar objekt i së cilës ka qenë shitja e pesë ngastrave tokësore nuk është kundërshtuar nga të paditurat.

Si pasojë, Dhoma e Posaçme konsideron se padiësit kanë sjellë prova se e drejta e pronësisë mbi ngastrat e kontestuara ishte fituar nga para-ardhësit e tyre dhe se këta e kanë fituar këtë të drejtë në bazë të trashëgimisë.

Prandaj, vetëm ndonjë titull i mëvonshëm apo fitues i pronës mbi ngastrat e kontestuara do të mund ta bindte gjykatën se Padiësit nuk janë më pronarë të tokës në fjalë.

Meqenëse të paditurat AKM dhe AKP, në cilësinë e tyre si administruese pasuese të NSH-së, e paditura e parë, pretendon se NSH Kooperativa Bujqësore [REDAKTUAR] apo Komuna e Pejës e kanë fituar pronësisë e atyre ngastrave, ato mbajnë barrën e provave për predominimin e titullit të pronësisë së pohuar.

Argumenti i parë i AKM-së qëndron në shpjegimin se ka kompetencë administrative për pronën shoqërore të regjistruara si të tilla në vitin 1989. Dhoma e Posaçme nuk e konteston se kjo është pjesë e mandatit të Agjencisë; mirëpo ajo konsideron se kjo nuk do të thotë se titulli i pronësisë është fituar vetëm në bazë të faktit se ngastra e tokës është regjistruar në dokumente kadastrale në emër të NSH-së.

Regjistrimi kadastral nuk është titull pronësie por është vetëm regjistrim mi një titulli të pronësisë. Andaj, ky regjistrim vetvetiu nuk është provë e titullit të pronësisë. Ai duhet të vërtetohet me bazë ligjore mbi të cilën është bërë, siç edhe konstatohet me Nenin 3 të Ligjit të sipër-përmendur mbi Regjistrimin e Pasurive të Patundshme në Pronësi Shoqërore.

Të paditurat e më pastaj, sipas urdhrit të Dhomës së Posaçme, Komuna e Pejës nuk kanë mundur t'ia sigurojë Dhomës së Posaçme dokumentin i cili do të mbahej si provë e transferim të së drejtës pronësore në NSH Kooperativa Bujqësore [REDACTED].

Në certifikatën e saj të datës 12 dhjetor 2006, Drejtoriati për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë (Komuna e Pejës) ka shpjeguar se ngastrat tokësore në kontest janë evidentuar në emër të [REDACTED] (shitës sipas kontratës së datës 10 prill 1952) “pas matjeve të para në vitin 1932 deri në vitin 1954” dhe “sipas regjistrit mbi ndërrimet 1/1954” është transferuar tek NSH-ja. Drejtoriati ka përmendur: “Ne theksojmë se ndërrimet janë bërë në vitin 1954, Drejtoriati nuk posedon ndonjë dokument ligjor.

Sipas kërkesës së Dhomës së Posaçme, Paditësit kanë siguruar një tjetër certifikatë po ashtu të shkruar nga Drejtoriati për Kadastër, m Gjeodezi dhe Pronë (Komuna e Pejës) me datë 21 korrik 2007 në të cilën Drejtori thotë: “me fjalë”ky drejtoriat nuk posedon ndonjë dokument ligjor”do të thotë se nuk ekziston ndonjë kontratë, vendim administrativ apo të gjykatës e as ndonjë deklaratë unilaterale e palës-pronarit se ai /ajo e heq dorë nga prona e tij/saj ën favor të pronësisë shoqërore.”

Në këtë certifikatë të fundit, Drejtoriati po ashtu ka shtuar se në vitin 2006, sipas regjistrimit mbi ndërrimet nr. 1/06, të gjitha pronat e patundshme nga lista poseduese nr. 28, në Zonën Kadastrale Joshanicë janë regjistruar në emër të Kooperativës Bujqësore [REDACTED] e jo më në emër të Kooperativës Bujqësore [REDACTED] të Joshanicës, në bazë të Vendimit të Kuvendit Komunal të Pejës nr. 02/463/274 të datës 30 qershor 1980.

Dhoma e Posaçme e ka shqyrtuar këtë vendim të paraqitur nga AKP dhe ka konstatuar se ai nuk është vendim gjyqësor apo vendim i ndonjë organi administrativ i cili përcakton se prona ka kaluar në pronësi shoqërore.

Në këtë vendim, Kuvendi Komunal i Pejës e ka miratuar kërkesën e paraqitur nga Kompanie e atëhershme e porsaformuar Bujqësore [REDACTED] për t'iu dhënë në shfrytëzim të përhershëm 44 ngastra tokësore të cila deri atëherë iu kishin ndarë Kooperativës Bujqësore të Joshanicës për arsye se kjo kooperativë ka pushuar së funksionuari.

Siç është cekur nga AKP, Dhoma e Posaçme mund të lexoi në arsyetimin e këtij vendimi se Gjykata Komunale në Pejë iu referonte faktit se toka në fjalë ka qenë e regjistruar në fondin e pronës shoqërore si lëndë e braktisur nga pronarët e mëhershëm.

Sidoqoftë, ky vendim vetëm e përmend një fakt të tillë si të pranuar pa iu referua shprehimisht vendimit me të cilin toka ka mundur të shpallet si pronë shoqërore. Me fjalë tjera ky vendim i lëshuar në vitin 1980 nuk jep ndonjë informacion të qartë për bazën ligjore të transferim të së drejtës pronësore të ngastrave në kontest, e as për natyrën e vendimit i cili ka mundur të lëshohet për transferimin e tillë (konfiskim, shpronësim, nacionalizim..etj.) e as për datën dhe autorin e tij.

Për më tepër, fakti i braktisjes së tokës të cilit ajo i referohet, është në kundërshtim me faktin e provuar shprehimisht përmes vendimit të Gjykatës Komunale dhe Gjykatës së

Qarkut në Pejë të lëshuar me 1 korrik 1981, respektivisht 12 tetor 1981 i cili cekte se NSH Kooperativa Bujqësore [REDAKTUAR] i ka penguar Paditësit nga posedimi fizik i ngastrave të kundërshtuara, braktisja e pohuar e tokës nuk ka mundur të jetë shkak faktik i një vendimi eventual formal me të cilin transferohet e drejta e pronësisë në NSH.

Pastaj, Dhoma e Posaçme vendosi që të kërkoj nga Komuna e Pejës të gjitha dokumentet rreth procedurës eventuale e lila ka mundur të ketë lidhje me ngastrat e kundërshtuara. Në përgjigjen e saj të datës 18 tetor 2010, Komuna e Pejës ka cekur se nuk ka qenë në gjendje të gjejë se me çfarë baze ligjore është bërë transferimi i pronësisë.

Nga dokumentacionet e cekura më lart, Dhoma e Posaçme nxjerr konkluzion se meqë baza ligjore për transfero mund të paraqitet, do të thotë se të paditurat nuk kanë sjellë asnjë provë për transferimin e së drejtës së pronësisë të ngastrave në fjalë ën favor të NSH Kooperativa Bujqësore [REDAKTUAR].

Si rrjedhojë, meqë si e drejta e vetme e pronësisë evidentohet ajo e Paditësve, Dhoma e Posaçme e pranon padinë dhe cekë se Paditësit janë pronarë të ligjshëm të ngastrave të kundërshtuara. E drejta e pronësisë duhet të regjistrohet ne kadastër.

3 Shpenzimet e procedurës

Sipas Nenit 11 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4, dhe Nenit 56.2 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2008/6, shpenzimet procedurale paguhen nga pala gjyq-bjerrëse, këtu NSH e përfaqësuar nga AKP për faktin se padia e Paditësve është miratuar.

Në pajtim me Nenin 10 të Udhëzimit Administrativ të Këshillit Gjyqësor nr. 2008/2 lidhur me Rregullat Plotësuese të Procedurës mbi taksat gjyqësore të vendosura nga Kryetari i Dhomës së Posaçme, taksat e Dhomës mbështetën në bazat si vijon:

- Për paditë që kalojnë shumën prej 5,001 deri 10 000 (Neni 10.1); taksa prej 50 Euro;
- Për lëshimin e Aktgjykimit (Neni 10.12); taksa prej 50 Euro.

Në rastin konkret, vlera e padisë nuk është përcaktuar nga Paditësit por Dhoma e Posaçme konsideron se vlera e ngastrave të kundërshtuara siç përshkruhet nga Paditësit është në mënyrë të arsyeshme midis 5, 000 – 10.000 Euro. Andaj shuma e shpenzimeve gjyqësore është 100 Euro. Paditësi tashmë e ka paguar shumën prej 50 Euro, prandaj, NSH Kooperativa Bujqësore [REDAKTUAR] detyrohet që tua kompensoi Paditësve këtë shumë dhe ti paguajnë në Dhomë të Posaçme shumën prej 50 Euro.

Paditësit nuk kanë paraqitur kërkesë për kompensimin e shpenzimeve të tyre të procedurës

4 Këshillë Juridike:

Në kuptim të Nenit 9.5 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4, ankimi kundër këtij vendimi mund të ushtrohet në shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit brenda tridhjetë (30) ditëve nga pranimi i këtij vendimi.

Prandaj është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Antoinette Lepertier-Durel,
Gjyqtare Kryesuese, EULEX

nënshkruar

Esmā Ertezi,
Gjyqtare EULEX

nënshkruar

Sabri Halili,
Gjyqtar

nënshkruar

Tobias Lapke,
Regjistrues EULEX

nënshkruar